

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XVIII, nr. 5647  
E premte, 7 dhjetor 2018  
çmimi 0.40 €

## Kurti ia bën të qarta propozimet e LV-së ambasadorit amerikan për dialogun

FAQE 6



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)



facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

### AKTUALE

#### KËRCËNIMET E STOLTENBERGUT DHE 'EKIPI I UNITETIT'!

F. 11

Behxhet Sh. SHALA  
- BAJGORA



#### QEVERIA MIRATON KËRKESËN E MINISTRISË SË INFRASTRUKTURËS PËR STRATEGJINË HEKURUDHORE

F. 7

#### MATOSHI E QUAN TË SUKSESSHËM AKSIONIN 'TA PASTROJMË KOSOVËN'

F. 7

### EKONOMI

#### KËRKOHET QË TË PUNOHET MË SHUMË NË SEKTORIN BANKAR

F. 8


#### KRASNIQI: MBPZHR-ja KA OFRUAR MBËSHTETJE TË MADHE FINANCIARE PËR KULTIVUESIT E PEMËVE TË IMËTA

F. 8

### KULTURË

#### VDEKJA E KRISTIAN GYTIT, HUMBJE E MADHE PËR KULTURËN SHQIPTARE

F. 13



Rexhep QOSJA

### SPORT

#### BATATINA: LLAPI FITON TITULLIN DHE DEL NË EVROPË

F. 18

FLET PËR "EPOKËN E RE", AGIM BAHTIRI

FAQE 4-5

## Ndërkombëtarët kanë dështuar për hapjen e urës së Ibrit



Kryetari i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, ka akuzuar ndërkombëtarët se kanë dështuar për hapjen e urës së lumit Ibër. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se kjo urë

qëllimisht nuk është hapur për lëvizje. Sipas tij, kjo çështje do të bëhet pjesë e negociatave të Brukselit për ta kushtëzuar Kosovën me praninë e ndonjë marrëveshjeje me Serbinë. Bahtiri ka

thënë se Kosova në këtë proces nuk duhet ta pranojë asnjë kushtëzim, kurse e ka ftuar spektrin politik të arrijë një konsensus kombëtar për fazën finale të dialogut Kosovë - Serbi

## Vërejtjet e NATO-s nuk e zbrapsin Kosovën për formimin e ushtrisë

Pavarësisht prej vërejtjeve të NATO-s, kryeministri i vendit, Ramush Haradinaj, ka shprehur vendosmërinë e Kosovës për ta vazhduar procesin e transformimit të FSK-së në ushtri. Nëpërmjet një bisede telefonike, Haradinaj e ka siguruar sekretarin e përgjithshëm të NATO-s, Jens Stoltenberg, se transformimi i FSK-së do të jetë transparent dhe në bashkëpunim të ngushtë me NATO-n për një ushtri profesionale dhe në shërbim të gjithë qytetarëve. Ai i ka



thënë Stoltenbergut se transformimi i FSK-së, që do të votohet më 14 dhjetor, është vendim sovran i Kosovës

FAQE 3



## Projektbuxhet i për vitin 2019 përkrahet nga pozita, kritikohet nga opozita

FAQE 9

**RENOVA**  
PUTZ  
Macedoni  
Xhepcisht-Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegijbiznesi.com](http://www.kolegijbiznesi.com)  
info@kolegijbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302  
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

**DINO**  
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë  
tel & fax +381 38 566 666

# Britania e Madhe mbështet perspektivën euroatlantike të Kosovës

Ministri për Evropë dhe Amerikë në Qeverinë britanike, Alan Duncan, në takim me presidentin e Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, ka thënë se Britania e Madhe mbështet perspektivën euroatlantike të Kosovës dhe të rajonit për të ndërtuar paqe e stabilitet të qëndrueshëm në Evropën Juglindore

PRISHTINË, 6 DHJETOR - Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, pas Shteteve të Bashkuara të Amerikës, ka udhëtuar për një vizitë njëditore në Britaninë e Madhe.

Presidenti Thaçi të enjten në Londër ka takuar Sir Alan Duncan, ministër për Evropë dhe Amerikë në Qeverinë britanike.

Kreu i shtetit e ka njoftuar ministrin britanik për përpjekjet për ndërtimin e paqes së qëndrueshme në Kosovë dhe rajon. "Kosova ka bërë hapa të mëdhenj në reforma dhe është e interesuar që të vazhdojë me këta hapa edhe në të ardhmen", ka thënë presidenti Thaçi.

"Po punojmë edhe për një marrëveshje paqësore, gjithëpërfshirëse dhe përfundimtare me Serbinë", ka shtuar ai.

Në anën tjetër, ministri Duncan ka thënë se Britania e Madhe mbështet perspektivën euroatlantike të Kosovës dhe të rajonit. "Mbështesim përpjekjet për të ndërtuar paqe e stabilitet të qëndrueshëm në tërë rajonin e Evropës Juglindore", u shpreh ministri Duncan.

Presidenti Thaçi në takim me ministrin Duncan ka theksuar se Kosova dëshiron të bëhet kontribuuese në paqen në rajon dhe më gjerë, si dhe në shërbim të kësaj janë edhe përpjekjet për një marrëveshje me Serbinë, e cila do të sjellë njohjen reciproke dhe mbylljen e kapitullit të konfliktit.

Me ministrin Duncan, presidenti Thaçi ka folur edhe për angazhimet për të përmbyllur procesin e transformimit të Forcës së Sigurisë së Kosovës.



## Shqipëria merr presidencën e OSBE-së në 2020

TIRANË, 6 DHJETOR - Shqipëria do të ketë presidencën e OSBE-së në vitin 2020. Vendimi është marrë të enjten gjatë Këshillit të ministrave të Organizatës për Sigurinë dhe Bashkëpunimin në Evropë, dhe u bë i ditur nga Presidenca italiane e kësaj organizate. Përmes një postimi në Twitter, Presidenca italiane "përgëzon Shqipërinë për arritjen e këtij objekti të rëndësishëm". Kandidatura e Shqipërisë për kryesimin e OSBE-së u bë e ditur pak muaj më parë nga kryeministri Edi Rama, në përfundim të takimit që ai pati në Tiranë me ministrin e Jashtëm gjerman Heiko Maas, ndërsa kërkoi mbështetjen e Berlinit. Sipas



kryeministrit Rama diçka e tillë do të ishte "një kontribut edhe në funksion të dinamikave në rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe procesit të integritetit të tij evropian, si dhe një nxitje jo vetëm për Shqipërinë por dhe vetë rajonin". Vetë ministri i Jashtëm Ditmir Bushati, ndërmori një fushatë lobimi për të siguruar mbështetjen e vendeve anëtare.

## Protesta në Tiranë, studentët nuk tërhiqen nga kërkesat

Tiranë, 6 dhjetor - Studentët nuk tërhiqen dhe nuk mashtrohen. Ata rrethuan të enjten Ministrinë e Arsimit, duke qenë me mijëra vetë, çka krijoi një iluzion të dhjetorit 1990. Vargu i pafund i studentëve pushtoi bulevardin kryesor të Tiranës, ku u ndalën para zyrës së kryeministrit e më pas drejt Ministrisë së Arsimit. Tirana u paralizua nga protesta e studentëve, të cilët kërkonin zgjedhje për hallet ekonomike, sepse tarifën ishin të larta. Në fillim kryeministri e mori me të qeshur, por kur pa mijëra studentë, nxori ministrin e Arsimit Lindita Nikolla, e cila në një konferencë urgjente për mediet ka deklaruar

se qeveria do të tërhiqet nga vendimi i saj për vendosjen e tarifave të studentëve në universitet publike. Ministria Nikolla deklaroi se "neni 4 i vendimi të Këshillit të Ministrave që prek tarifën do të hiqet". Por kjo është vetëm një pikë e kërkesave të studentëve. Studentët bëjnë të ditur se edhe pas deklaratës së ministres Lindita Nikolla nuk tërhiqen nga protestat. Gjatë dy ditëve të protestës studentët kanë paraqitur një listë me kërkesa. "Janë edhe katër kërkesa të tjera që kemi bërë. Nuk mjafton vetëm heqja nga tarifën", deklaruan drejtuesit e protestës së studen-

tëve. Studentët thonë se protesta do të vijojë deri në plotësimin e gjithë kërkesave të tyre për arsim të financuar më shumë nga shteti dhe kushte më komode në universitete. Studentët deklarojnë se tubimet do të vijojë edhe para Kryeministrit, nëse qeveria nuk plotëson gjithë kërkesat e tyre. Ndërkohë qeveria ka prekur buxhetin e shtetit duke ua kaluar një pjesë të fondeve universiteteve private. Studentët janë të vendosur që universitetet publike të jenë falas si dhe të ketë kushte njerëzore, e jo siç janë katandisur sot si mos më keq-deklarojnë studentët.

## CDU-ja zgjedh kryetarin e partisë, pasardhësin e Angela Merkel

BERLIN, 6 DHJETOR - Partia gjermane në pushtet, CDU, do të zgjedhë sot (e premte) pasardhësin e Angela Merkel në krye të partisë dhe si rrjedhojë e saj, edhe kandidatin për kancelarin e ri të vendit.

Mediet botërore shkruajnë për largimin e kancelares gjermane dhe zgjedhjen e pasardhësit të saj.

Udhëheqësja e CDU dhe kancelarja e Gjermanisë që nga viti 2005, Angela Merkel njoftoi në tetor se largohet nga pozita e liderit të partisë dhe nuk kishte në plan të rihapte garën për postin e kancelares.

Zgjedhja e pasardhësit të saj do të bëhet në një kongres partiak në Hamburg, ku marrin pjesë 1.001 delegatë.

Ndër delegatët, do të ketë shumë politikanë profesionistë apo të rastësishëm në nivel shtetëror, rajonal apo lokal.

Sekretarja e përgjithshme e CDU-së, Aneghart Kramp Karenbauer, e njohur gjithashtu për nofkën AKK, është një nga kandidatët për pasardhësin e Angela Merkel, por aleati i saj besohet të jetë më i afërt me

pozicionet qendrore të Merkelit.


Ndërkohë mediet gjermane njoftojnë se tensioni është rritur brenda partisë konservatore gjermane CDU për linjën drejtuese që do të vendoset pas largimit të parashikuar të Angela Merkel, në hapje të kongresit, i cili do të përzgjedhë edhe pasuesin e saj.



Kryeministri Ramush Haradinaj ka zhvilluar të enjten një bisedë telefonike me sekretarin e përgjithshëm të NATO-s, Jens Stoltenberg

## Vërejtjet e NATO-s nuk e zbrapsin Kosovën për formimin e ushtrisë

Pavarësisht prej vërejtjeve të NATO-s, kryeministri i vendit, Ramush Haradinaj, ka shprehur vendosmërinë e Kosovës për ta vazhduar procesin e transformimit të FSK-së në ushtri. Nëpërmjet një bisede telefonike, Haradinaj e ka siguruar sekretarin e përgjithshëm të NATO-s, Jens Stoltenberg, se transformimi i FSK-së do të jetë transparent dhe në bashkëpunim të ngushtë me NATO-n për një ushtri profesionale dhe në shërbim të gjithë qytetarëve. Ai i ka thënë Stoltenbergut se transformimi i FSK-së që do të votohet më 14 dhjetor është vendim sovran i Kosovës



Aleksandar Vučić, në deklaratën e NATO-s është thënë se Stoltenbergu i ka përmendur presidentit serb nevojën për t'i

zbutur tensionet. "Ua kam rikujtuar të dyve se dialogu i ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian, në mes të Prishtinës dhe

Beogradit, është rruga e vetme për të arritur paqe dhe stabilitet në rajon", është theksuar në deklaratën e NATO-s.

**EPOKA E RE** Shqipe HETEMI

**PRISHTINË, 6 DHJETOR** - Vërejtjet e NATO-s nuk e kanë zbrapsur kryeministrin e Kosovës, Ramush Haradinaj, për ta finalizuar procesin e transformimit të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) përmes ligjit. Për këtë çështje kryeministri Haradinaj të enjten ka zhvilluar një bisedë telefonik me sekretarin e përgjithshëm të NATO-s, Jens Stoltenberg, të cilën e ka siguruar se transformimi i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) do të jetë transparent dhe në bashkëpunim të ngushtë me NATO-n për një ushtri profesionale, shumetnike dhe kredibile në shërbim të të gjithë qytetarëve të Kosovës. Po ashtu, Haradinaj i ka thënë Stoltenbergut se vendimi për transformimin e FSK-së që do të votohet më 14 dhjetor është vendim sovran i Kosovës dhe përmban në vete vizionin dhe vullnetin e qytetarëve të Kosovës që t'i ruajnë dhe mbrojnë vlerat perëndimore. "Ky vendim sovran i Kosovës, i cili do të votohet më 14 dhjetor, përmban në vete vizionin dhe vullnetin e qytetarëve të Kosovës që të ruajnë dhe t'i mbrojnë vlerat perëndimore. FSK-ja do të kontribuojë për paqen dhe stabilitetin në rajon dhe më gjerë. Institucionet e Kosovës do të sigurohen që ta vazhdojnë bashkëpunimin e ngushtë me KFOR-in dhe NALT, pasi që ndajmë të njëjtat shqetësime të sigurisë, interesat dhe vlerat", ka thënë kryeministri Haradinaj në bisedën telefonike me sekretarin

e përgjithshëm të NATO-s, Jens Stoltenberg. Me këtë rast kryeministri Haradinaj sekretarit të NATO-s i ka shprehur falënderimin e tij dhe të popullit të Kosovës për misionin e KFOR-it në Kosovë dhe kontributin e NATO-s për një ambient të qetë dhe të sigurt për të gjithë qytetarët e Kosovës. Po ashtu, Haradinaj i ka shprehur Stoltenbergut respektin dhe ndjenjën e veçantë për shumë ushtarë të NATO-s që kanë humbur jetën gjatë shërbimit të tyre në Kosovë në mbrojtje të paqes dhe sigurisë në vendin tonë. Për bisedën me kryeministrin e Kosovës, Ramush Haradinaj dhe presidentin e Serbisë, Aleksandar Vučić, ka folur edhe sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, i cili ka thënë se si Prishtinës, po ashtu edhe Beogradit, u ka potencuar nevojën për qetësi dhe përmbajtje, si dhe anashkalimin e ndonjë hapi apo deklaratë provokuese. "Me Haradinajn kam shqyrtuar planin për transformimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës në Ushtri. Kam theksuar se një hap i tillë vjen në kohë të papërshtatshme dhe është kundër këshillës së dhënë nga disa aleatë të NATO-s, andaj mund të ketë pasoja negative në perspektivën e Kosovës për integrim euroatlantik", është thënë në deklaratën e NATO-s. Po në këtë deklaratë është theksuar se nëse do të rritet mandati i FSK-së, NATO-s i duhet ta shqyrtojë nivelin e bashkëpunimit me këtë forcë. Kurse sa iu përket bisedimeve me presidentin serb,

### Serveri mbështet transformimin e FSK-së në ushtri, kritikon qëndrimin e NATO-s

Analisti amerikan Daniel Serwer ka deklaruar se NATO është duke e mbështetur Beogradin, pasi është duke kundërshtuar krijimin e ushtrisë së Kosovës. Në një shkrim autorial, Serweri ka thënë se Serbia po kërcënon me ndërhyrje në Kosovë nëse Kuvendi i Kosovës voton për ta krijuar ushtrinë. "Kosova nuk ka ushtri që nga ndërhyrja e NATO-s në vitin 1999 që e shpëtoi atë nga përpjekjet e presidentit Millosheviq për ta reduktuar popullsinë e saj shqiptare me forcë dhe shpalljen e pavarësisë së saj në 2008-n. NATO ka siguruar mbrojtjen territoriale të vendit, edhe pse ajo qeveris vetë dhe është njohur si shtet sovran nga rreth 110 vende", ka thënë ai, duke shtuar se Prishtina tani dëshiron t'i konvertojë forcat e saj të sigurisë, të cilat janë të armatosura lehtë, në një ushtri. "ShBA-ja, Britania e Madhe dhe

NATO janë konsultuar tërësisht. Procesi do të zgjasë 10 vjet ose më shumë. Nëse forcat e NATO-s ndonjëherë do të largohen nga Kosova dhe do të dërgohen në misionet me prioritet të lartë, vendi do të duhet të ketë mjetet për të mbrojtur veten, të paktën për disa ditë. NATO duhet të mbështesë ata që duan ta lehtësojnë barrën e saj, jo ata që kërcënojnë agresionin", ka vlerësuar Serweri. Ai ka thënë se ushtria e Kosovës nuk ka të bëjë me kërcënim për të ardhmen në rajon. "Ajo që Serbia po përpiqet të bëjë është që ta privojë Prishtinën nga një prej elementeve vitale të sovranitetit. Po përpiqet të gjejë një justifikim për të ndërhyrë dhe për ta pushtuar pjesën me shumicë serbe të veriut të Kosovës, ku figurojnë figura të kriminit të organizuar në përputhje me autoritetet qeverisëse të

Beogradit", ka thënë ai. Serweri e ka quajtur gabim serioz mbështetjen që, sipas tij, NATO-ja po ia jep agjendës së Beogradit. Amerikani është shfaqur kritik edhe ndaj BE-së për shtyrjen e afatit për liberalizimin e vizave për Kosovën. Megjithatë, Serweri e cilëson si gabim vendimin e Qeverisë së Kosovës për t'u vënë taksë produkteve të Serbisë. "Tarifat prej 100 përqindësh që kohët e fundit iu imponuan importeve të Serbisë janë shkelje e detyrimeve të saj ndërkombëtare sipas Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore (CEFTA), por ky gabim do të korrigjohet përmes procesit normal të CEFTA-s", është shprehur Serweri. Sipas tij, Kosova, po aq sa Serbia, ka nevojë për perspektiva euroatlantike nëse të dy vendet do t'i shpëtojnë spirales negative në të cilën janë mbyllur.

### Shënohet 15-vjetori i Agjencisë së Kosovës për Forenzikë

**PRISHTINË, 6 DHJETOR (ER)** - Agjencia e Kosovës për Forenzikë (AKF) e Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB) ka mbajtur të enjten ceremoninë e 15-vjetorit të themelimit të saj. Ministri i Punëve të Brendshme, Ekrem Mustafa, në këtë ceremoni ka theksuar se, duke u nisur nga misioni dhe qëllimi i

themelimit dhe funksionimit të AKF-së si institucion shtetëror me një rol të veçantë në sistemin e sigurisë dhe drejtësisë në shtetin, është një privilegj, por edhe përgjegjësi dhe sfidë për menaxhimin e përgjithshëm të saj. Ai ka shtuar se Agjencia e Kosovës për Forenzikë do ta ketë përkrahjen



e tij dhe drejtimin e duhur të përcaktuar me Ligjin për AKF-

në dhe legjislacionin përcjellës të aprovuar. "Falë angazhimit të të gjithë personelit të AKF-së dhe me mbështetjen time të rezervuar në të gjitha drejtimit, sukseset nuk do të mungojnë edhe në vitet vijuese", ka thënë Mustafa. Ndërsa kryeshefi i AKF-së, Blerim Olluri, ka thënë se kjo

agjenci gjatë këtyre viteve ka luajtur rol të rëndësishëm në zbardhjen e veprave penale ku të gjitha ekspertizat janë kryer sipas standardeve më të larta ndërkombëtare. Me këtë rast para të pranishmëve është paraqitur edhe një film dokumentar i shkurtër lidhur me historikun e themelimit të AKF-së.

Flet për "Epokën e re", Agim Bahtiri

# Ndërkombëtarët kanë dështu



Kryetari i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, ka akuzuar ndërkombëtarët se kanë dështuar për hapjen e urës së lumit Ibër. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se kjo urë qëllimisht nuk është hapur për lëvizje. Sipas tij, kjo çështje do të bëhet pjesë e negociatave të Brukselit për ta kushtëzuar Kosovën me praninë e ndonjë marrëveshje me Serbinë. Bahtiri ka thënë se Kosova në këtë proces nuk duhet ta pranojë asnjë kushtëzim, derisa e ka ftuar spektrin politik të arrijë një konsensus kombëtar për fazën finale të dialogut Kosovë - Serbi

**EPOKA  
ERE****Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 6 DHJETOR - Kryetari i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, ka kritikuar bashkësinë ndërkombëtare për neglizhencë për moshapjen e urës mbi lumin Ibër. Ai ka deklaruar se bashkësia ndërkombëtare ka dështuar për hapjen e kësaj ure për lëvizje. Në

këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Bahtiri ka treguar se edhe ky mosveprim i ndërkombëtarëve ka ndikuar në nisjen e iniciativës së tij për bashkimin e Komunës së Mitrovicës Veriore me atë Jugore. "Bashkësia ndërkombëtare ka dështuar totalisht për hapjen e urës dhe për zbatimin e marrëveshjes për këtë çështje që

është arritur në Bruksel. Dështimi i sajë neve na ka shtyrë edhe më shumë ta fillojmë iniciativën tonë për bashkimin e qytetit", ka thënë Bahtiri. Ai ka bërë me dije se ura e Ibrit nuk është hapur me qëllim që kjo çështje të bëhet pjesë e negociatave të Brukselit në fazën finale të dialogut Kosovë-Serbi. Sipas Bahtirit, kjo bëhet për ta

kushtëzuar Kosovën në këtë proces të dialogut. "Brukseli dëshiron që në dorën e tyre ta ketë një çelës që kushtëzon Kosovën për një marrëveshje të mundshme në këtë fazë të dialogut. Liberalizimin e vizave, Interpolin, hapjen e urës, rrymën dhe të gjitha çështjet e tjera që lidhen me këtë proces të dialogut, bashkësia ndërkombëtare dëshiron t'i ketë si një çelës në dorë për ta kushtëzuar Kosovën që ta pranojë një kompromis", ka thënë Bahtiri, duke shtuar se Kosova në këtë proces në asnjë mënyrë nuk duhet t'i pranojë kushtëzimet. "Unë po ju them në mënyrë të qartë se asnjëherë, në asnjë mënyrë, ne nuk do ta pranojmë ndarjen e Kosovës e as prekjen e asnjë pëlëmbje të territorit të Kosovës", është shprehur ai.

I pari i Mitrovicës e ka ftuar spektrin politik që të arrijë një konsensus rreth dialogut me Serbinë. Sipas Bahtirit, kushdo që pranon ndarjen e Mitrovicës do të jetë i fundosur politikisht. Në këtë intervistë Bahtiri ka folur edhe për iniciativën për bashkimin e dy komunave në një të vetme. Ai ka treguar se nëse Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAP) e konsideron këtë iniciativë të kundërligjshme atëherë do ta fillojë mbledhjen e nënshkrimeve për t'iu drejtuar Kuvendit të Kosovës. "Kjo është një iniciativë e bazuar në vullnetin e qytetarëve të kësaj komune, prandaj institucionet tona duhet ta respektojnë atë. Unë jam së bashku me qytetarët dhe e dëgjoj zërin e tyre. Nëse kjo nuk kalon në MAPL, atëherë do t'u drejto-

# Iar për hapjen e urës së Ibrit

veprim edhe duke parë situatën aktuale e cila mbretëron në pjesën veriore të Mitrovicës.

**"Epoka e re":** E keni dorëzuar këtë kërkesë të kësaj iniciative në Qeveri?

**Bahtiri:** Jo, ende nuk e kemi dorëzuar në Qeveri, sepse ajo tani shkon në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, pastaj kjo ministri na kthen një përgjigje nëse kërkesa jonë është e ligjshme apo e paligjshme. Pastaj Kuvendi Komunal më obligon mua ta dorëzoj në Qeverinë e Republikës së Kosovës këtë iniciativë.

**"Epoka e re":** Çfarë nëse MAPL-ja ju kthen përgjigje negative duke jua vlerësuar të kundërligjshme iniciativën. Do ta respektoni qëndrimin e ministrit?

**Bahtiri:** Mendoj se kjo është një iniciativë e ligjshme dhe normale. Kjo është një iniciativë e bazuar në vullnetin e qytetarëve të kësaj komune, prandaj institucionet tona duhet ta respektojnë atë. Unë jam së bashku me qytetarët dhe e dëgjoj zërin e tyre. Nëse kjo nuk kalon në MAPL, do t'u drejtohem qytetarëve të Mitrovicës që t'i mbledhim mbi 10 mijë nënshkrime dhe t'i drejtohem Kuvendit të Kosovës për këtë iniciativë ligjore.

**"Epoka e re":** Në opinionin publik jeni kritikuar për këtë iniciativë, duke pretenduar se një veprim i tillë mund të nxisë tensione në atë pjesë të vendit?

**Bahtiri:** Përkundrazi, tensione mund të sjellin marrëveshjet e fshehta që janë duke u bërë. Tani është koha e duhur që të kërkohet bashkimi i Mitrovicës. Nëse institucionet më të larta të Kosovës nuk e kuptojnë këtë e kanë shumë gabim. Prandaj unë nuk marrë asnjë iniciativë pa e menduar mirë dhe pa e planifikuar mirë. Po ju them juve dhe gjithë të tjerëve, se kjo iniciativë do të shkojë deri në fund dhe qyteti i ndarë i Mitrovicës do të bashkohet ashtu siç ka qenë.

**"Epoka e re":** Derisa po pretendoni bashkimin e dy komunave, ende nuk është hapur ura mbi lumin Ibër, e cila ishte planifikuar të ndodhë këtë vit?

**Bahtiri:** Bashkësia ndërkombëtare ka dështuar totalisht për hapjen e urës dhe për zbatimin e marrëveshjes për këtë çështje që është arritur në Bruksel. Dështimi i saj neve na ka shtyrë edhe më shumë që ta fillojmë iniciativën tonë për bashkimin e qytetit. Nuk ka të drejtë askush ta ndalojë hapjen e urës e cila i lidh dy pjesët e qytetit. Hapja e urës

është lehtësim për qytetarët e të dy pjesëve të qytetit dhe çdokush që e ndalon këtë, bën veprim jo të drejtë. Prandaj bashkësia ndërkombëtare është fajtorja kryesore për moshapjen e kësaj ure. Si përgjigje ndaj kësaj ne kemi marrë iniciativën tonë që Komuna Veriore e Mitrovicës t'i bashkohet Komunës Jugore dhe ta bashkojmë qytetin. Meqenëse bashkësia ndërkombëtare e neglizhon kaq shumë kryetarin e Mitrovicës së Jugut, po ju qartë ndërkombëtarëve dhe vendorëve se unë do t'ia dal.

**"Epoka e re":** Pse mendoni se ndërkombëtarët po e neglizhojnë hapjen e urës? A do të thotë kjo se këtë çështje po duan ta bëjnë pjesë të negociatave për fazën finale të dialogut në Bruksel?

**Bahtiri:** Brukseli dëshiron që në dorën e vet ta ketë një çelës që kushtëzon Kosovën për një marrëveshje të mundshme në këtë fazë të dialogut. Liberalizimin e vizave, Interpolin, hapjen e urës, rrymën dhe të gjitha çështjet e tjera që lidhen me këtë proces të

dialogut, bashkësia ndërkombëtare dëshiron t'i ketë në dorë për ta kushtëzuar Kosovën që ta pranojë një kompromis. Mirëpo, asnjëherë, në asnjë mënyrë, ne nuk do ta pranojmë ndarjen e Kosovës e as prekjen e asnjë pëllëmbë të territorit të Kosovës. Ai që mendon se kjo do të ndodhë, është jashtë procesit dhe do të jetë jashtë proceseve çdoherë.

**"Epoka e re":** Spektri politik në vend ende nuk po arrin ta gjejë një konsensus për fazën finale të dialogut. Cili është qëndrimi juaj për këtë?

**Bahtiri:** Të gjitha iniciativat e deritashme për këtë synim kanë qenë joreale. U bëj ftesë të gjitha partive politike, qoftë atyre në pushtet apo atyre në opozitë, që të bëhen bashkë për t'i dalë zot Kosovës në këtë proces. Ajo që po ndodh sot në Kuvendin e Kosovës, por edhe jashtë Kuvendit, nuk bën të ndodhë më. Duhet të jemi unikë që në këtë proces t'i themi stop hegjemonizmit serb ndaj Kosovës. Ne në Kosovë jemi denbabaden dhe serbët kanë ardhur këtu, e jo ne.

Prandaj ne nuk do të lejojmë që asnjë pëllëmbë e Kosovës të diskutohet në Bruksel. Kërkoj nga institucionet e Kosovës dhe krerët partiakë që të bashkohen për platformën e dialogut. Po në këtë proces duhet të jenë njerëz të përgjegjshëm dhe të devotshëm që të mos lejojnë në asnjë mënyrë ndryshimin e kufijve.

**"Epoka e re":** Pra, besoni se në këtë proces Kosova mund të dalë mirë vetëm si e bashkuar?

**Bahtiri:** Sigurisht se bashkimi i spektrit politik për këtë fazë të dialogut do ta bëjë më të fuqishëm Kosovën në këtë proces. Bashkimi bën fuqinë, dhe ne duhet ta bëjmë këtë. Çdokush që mendon ta ndajë Kosovën duhet ta dijë shumë mirë se Mitrovica do të jetë tërmeti kryesor i çdokujt që e ka nisur atë iniciativë. Qytetarët e Mitrovicës e dinë çka është ndarja, ata e dinë se çka është të jesh refugjat në qytetin e vet, ngase ata nuk mund të shkojnë në shtëpitë e tyre që 20 vjet. Ndarja e Mitrovicës do ta fundoste çdokënd, çdo politikan që do ta fillonte këtë proces.

## Nga java e ardhshme pritet të hiqet taksa në Stacionin e Autobusëve

PRISHTINË, 6 DHJETOR (ER) - Kryetari i Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti, ka njoftuar të enjten se aksionarët e rinj të Stacionit të Autobusëve të Prishtinës kanë kërkuar nga bordi i ri që të shfuqizohet vendimi për taksën që qytetarët paguanin për të hyrë në stacione që ka qenë

në tri nivele: 0.10, 0.50 dhe 1 euro.

Ahmeti përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook" ka bërë me dije se pret që ky vendim të merret në fillim të javës tjetër dhe që duke filluar nga java e ardhshme, kjo taksë të mos paguhet nga qytetarët. "Gjatë javëve në vijim bordi

do të merret edhe me adresimin e shumë ankesave për parregullsi në administrimin e Stacionit të Autobusëve gjatë periudhës kur nuk kemi pasur qasje të plotë në dokumentacionin dhe qeverisjen e kësaj ndërmarrjeje publike", ka thënë kryetari i Prishtinës, Shpend Ahmeti.



hem qytetarëve të Mitrovicës që t'i mbledhim mbi 10 mijë nënshkrime dhe t'i drejtohem Kuvendit të Kosovës për këtë iniciativë ligjore", është shprehur kryetari Bahtiri.

**"Epoka e re":** Z. Bahtiri, pse pikërisht tani Kuvendi i Komunës së Mitrovicës ka kërkuar nga Qeveria ta iniciojë ndryshimin e ligjit për kufijtë administrativë të komunave, me qëllim të bashkimit të qytetit të Mitrovicës në një komunë?

**Bahtiri:** Qytetarët e kësaj komune më kanë kërkuar ta bëj një gjë të tillë. Ata e kanë vlerësuar nevojën që pjesa veriore të kthehet nën menaxhimin e Mitrovicës ashtu siç ka qenë më herët. Pra, mua më kanë shtyrë qytetarët ta ndërmarr këtë iniciativë. Po ashtu, e kemi marrë këtë

# Limaj: E padrejtë që qytetarët e Kosovës të mbesin edhe më tej të izoluar

PRISHTINË, 6 DHJETOR (ER) - Zëvendëskryeministri i Kosovës, Fatmir Limaj, ka pritur në takim ambasadorin e Hungarisë në Kosovë, Laszlo Markucz, me të cilin ka biseduar për zhvillimet e tanishme në vend, liberalizimin e vizave, rritjen e bashkëpunimit ekonomik mes dy vendeve dhe fazën finale të dialogut Kosovë - Serbi. Limaj ka theksuar nevojën e liberalizimit të vizave për qytetarët e Kosovës, duke shtuar se tashmë është konstatuar edhe nga Bashkimi Evropian se Kosova i ka përbushur të gjitha kriteret për liberalizim të vizave dhe është e padrejtë që qytetarët e Kosovës të mbesin edhe më tej të izoluar.

Sa i përket bashkëpunimit ekonomik mes dy vendeve, Limaj ka thënë se dy shtetet duhet ta thellojnë bashkëpunimin duke ftuar shtetin hungarez për investime në Kosovë.

Temë e këtij takimi ishte edhe

faza finale e dialogut me Serbinë. Limaj ka thënë se dialogu është temë nacionale dhe do të duhej një gjithëpërfshirje dhe konsensus sa më i gjerë, në mënyrë që marrëveshja përfundimtare të jetë e pranueshme nga të gjithë dhe të jetësohet në praktikë. Ai ka theksuar se marrëveshja përfundimtare mes dy vendeve për Kosovën nënkupton njohjen nga Serbia dhe anëtarësim në OKB e mekanizma të tjerë ndërkombëtarë.

Ndërsa ambasadori i Hungarisë në Kosovë, Laszlo Markucz, ka thënë se marrëveshja përfundimtare me Serbinë është në të mirë të dy vendeve dhe rajonit në përgjithësi. Ai ka ofruar mbështetjen e plotë të shtetit hungarez për arritjen e marrëveshjes përfundimtare me Serbinë. Zëvendëskryeministri Limaj ka falënderuar ambasadorin Markucz për ndihmën që shteti hungarez ka dhënë në vazhdimësi për Kosovën.



## Kurti ia bën të qarta propozimet e LV-së ambasadorit amerikan për dialogun



PRISHTINË, 6 DHJETOR (ER) - Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, bashkë me deputeten dhe anëtarën e Kryesisë, Fitore Pacolli, dhe aktivisten Valë Gjonbalaj, kanë pritur të enjten në takim ambasadorin e Irlandës, Pat Kelly, që mbulon Kosovën nga Hungaria. Në këtë takim përfaqësuesit e Lëvizjes Vetëvendosje kanë prezantuar qëndrimet mbi situatën politike në Kosovë dhe propozimet në lidhje me dialogun me Serbinë.

Kurti ka theksuar se fillimisht duhet bërë vlerësimi i dialogut në Kuvendin e Kosovës duke trajtuar raportin 38 faqesh të Qeverisë mbi arritjet dhe sfidat për zbatimin e marrëveshjeve të Brukselit gjatë periudhës 2011-2017. Sipas tij, më pas

duhet të dakordohemi për qëllimet tona e duke bërë listën e kërkesave të shtetit të Kosovës ndaj shtetit të Serbisë, duke përfshirë këtu dëmet e luftës, të pagjeturit, e shumë çështje të tjera për të cilat Serbia i ka mbetur borxh Kosovës.

Kurti ka thënë se më tutje duhet hartuar platforma me parimet e negociatave si dhe duhet të formohet ekipi negociator me udhëheqës kredibilë dhe strategjinë përkatëse. Gjatë këtij bisedimi është theksuar se dy hapat e fundit duhet të ndodhin vetëm pas zgjedhjeve të reja e të parakohshme për shkak se Qeveria e tanishme ka skandale të panumërta dhe nuk e ka shumicën në Kuvend, kurse për ta vazhduar dialogun nevojitet legjitimitet në qeverisje.

## SBASHK-u mbështet Programin Nacional për Rininë

PRISHTINË, 6 DHJETOR (ER) - Koordinatorin Nacional për Kulturë, Rini dhe Sport, Rexhep Hoti, ka pritur në takim kryetarin e Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, Rrahman Jasharaj, si dhe menaxherin e financave, Ymer Ymerin. Hoti ka shpallur para përfaqësuesve të SBASHK-

ut Programin Nacional për Rininë. "Qeveria e Kosovës për herë të parë ka aprovuar një program të tillë në nivel shtetëror që u jep mundësinë për pjesëmarrje në garë të gjithë nxënësve dhe studentëve pa dallim. Është një sistem që, përveç nxënësve dhe studentëve, do t'i ndihmojë edhe

mësimdhënësit, prindërit, shoqërinë civile dhe institucionet e tjera arsimore dhe qeveritare. Ky program do ta kthejë gjallërinë dhe entuziazmin e nxënësve nëpër shkolla dhe unë jam shumë i bindur se do të ndikojë edhe në parandalimin e shpërnguljeve të rinjve nga Kosova", ka thënë Hoti.



Është mbajtur takimi i radhës i Task Forcës për pastrimin e ambientit

# Matoshi e quan të suksesshëm aksionin 'Ta pastrojmë Kosovën'

Ministri i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), Fatmir Matoshi, ka thënë të enjten se aksioni "Ta pastrojmë Kosovën" ka qenë i suksesshëm. Ai ka treguar se gjatë periudhës së aksionit për pastrimin e ambientit janë marrë edhe disa veprime që do të kontribuojnë për ruajtjen e mjedisit. Ndërsa Luan Hasanaj nga organizata "Let's do it Kosova", duke prezantuar raportin preliminar për pastrimin e ambientit, ka bërë me dije se deri më tani 707 lokacione janë pastruar në gjithë territorin e Kosovës



EPOKA  
ERE **Faton DERMAKU**

PRISHTINË, 6 DHJETOR - Ministri i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), Fatmir Matoshi, së bashku me ministrin, zëvendësministrin dhe shoqërinë civile, të enjten kanë mbajtur takimin e radhës së Task Forcës për pastrimin e ambientit. Me këtë rast, ministri Matoshi ka thënë se MMPH-ja ka ndërmarrë një sërë veprimesh gjatë këtij tremujori të aksionit "Ta pastrojmë Kosovën". "E konsideroj të suksesshëm aksionin 'Ta pastrojmë Kosovën' edhe në plotësimin e aspektit ligjor. Kemi premtuar në fillim të fushatës që do të nënshkruhet dhe do të hyjë në fuqi udhëzimi administrativ për gjopa mandatore dhe ka një muaj që ky udhëzim ka përfunduar. Po ashtu, e kemi përfunduar edhe

draftin final të strategjisë për menaxhimin e mbeturinave ashtu siç jemi zotuar dhe kemi premtuar në fillim të kësaj fushate", ka deklaruar Matoshi.

Ministri Matoshi ka treguar se gjatë kësaj periudhe është shpallur edhe granti prej 1.2 milion eurosh për performancën e komunave më të suksesshme të aksionit "Ta pastrojmë Kosovën" ashtu siç ishte premtuar. Sipas Matoshit, gjatë periudhës së aksionit për pastrimin e ambientit janë marrë edhe disa veprime që do të kontribuojnë për ruajtjen e mjedisit. "Gjatë këtij aksioni kompanive të pastrimit u janë shpërndarë një mijë uniforma për punëtorët. Së bashku me GAC-in dhe 'Let's do it Kosova' jemi në hartimin e planit për shpërndarjen e 500 kontejnerëve dhe 500 shportave që do të vendosen në pika kufitare,

breze rrugore dhe përgjatë brezeve të liqeneve. Janë vendosur dhe po vazhdojnë të vendosen 500 tabela me të cilat kërkohet të mos hedhën mbeturina në vende të caktuara. Po ashtu, jemi përcaktuar për gjashtë kriteret që duhet t'i plotësojnë komunat për ta fituar grantin prej 1.2 milion eurosh", është shprehur Matoshi.

Ndërsa Luan Hasanaj nga organizata "Let's do it Kosova" ka prezantuar raportin preliminar për aktivitetet për pastrimin e

ambientit nga 15 shtatori deri më sot. "Janë 707 lokacione të cilat janë pastruar në të gjitha komunat e Kosovës gjatë periudhës sa ka zgjatur aksioni. Deponitë janë shumë të mëdha dhe ka lokacione që janë larguar deri 600 kamionë. Është një numër mbi 30 milionë mbetje ndërtimore të cilat janë larguar gjatë këtyre muajve sa ka zgjatur aksioni", ka deklaruar Hasanaj.

Ndërsa ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës, Rustem Berisha, ka treguar se ky

dikaster ka kontribuar për largimin e deponisë në Mirash të Obiliqit. "Forca e Sigurisë së Kosovës e ka mbështetur aksionin i cili ka filluar nga 15 shtatori deri më tani. Ne e kemi pasur një prej detyrave që t'i bartim mbeturinat nga deponia në Mirash-Obiliq. Deri më tani janë bartur 200 kamionë të mbeturinave", ka treguar Berisha. Edhe anëtarët e tjerë të Task Forcës për pastrimin e ambientit kanë raportuar për punët e kryera gjatë periudhës së këtij aksioni.

## Qeveria miraton kërkesën e Ministrisë së Infrastrukturës për Strategjinë Hekurudhore

EPOKA  
ERE **Qendresa RAMA**

PRISHTINË, 6 DHJETOR - Në mbledhjen e së enjtes kabineti qeveritar ka miratuar kërkesën e Ministrisë së Infrastrukturës për autorizim lidhur me aprovimin e Deklaratës së Përbashkët për Strategji të re Hekurudhore në Ballkanin Perëndimor, e cila shpreh gatishmërinë e shteteve të Evropës Juglindore për të ndërmarrë veprime duke siguruar: mbështetje në politika zhvillimore, aktivitete në koordinimin ndërinstitucional dhe ndër-shtetëror, mbështetje teknike, mbështetje financiare, mbështetje institucionale e cila është në dobi të të gjitha shteteve nënshkruese të kësaj deklarate. Vendimi i dytë që mori aprovimin e Qeverisë së Kosovës ishte Rregullorja për Autorizim, qëllimi i së cilës është njoftimi i praktikave dhe dhënia e autorizimit ndërmarrjeve për



ushtrimin e praktikave për të cilat kërkohet autorizimi. Qeveria e Kosovës në mbledhjen e sotme ka miratuar edhe Rregulloren për Përbajtjen dhe Mënyrën e Menaxhimit të Regjistrimit të Rregullave Teknike, e cila përcakton përbajtjen dhe

mënyrën e menaxhimit të regjistrimit të rregullave teknike të aplikueshme, rregullave teknike që janë duke u hartuar, trupave të emëruara për vlerësimin e konformitetit, dokumenteve të huaja të konformitetit të vlefshme në Republikën e Kosovës.

Edhe vendimi për të kërkuar nga presidenti i Republikës së Kosovës dhënie të autorizimit ministrit të Financave për nënshkrimin e Marrëveshjes Financiare për Projektin për Kadastër të Patundshmërisë dhe Infrastrukturës Gjeohapësinore

me Asociacionin Ndërkombëtar për Zhvillim ka marrë aprovimin e kabinetit qeveritar.

Nisma për miratimin e "Protokollit shtesë numër 6 për marrëveshjen për ndryshimin dhe pranimin e Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore është aprovuar nga qeveria në mbledhjen e sotme. Ky protokoll zbatohet për masat e miratuara ose të shfrytëzuara nga palët që ndikojnë në tregtinë e shërbimeve.

Kryeministri Haradinaj ka njoftuar kabinetin qeveritar lidhur me telefonatën që ka zhvilluar të enjten me sekretarin e përgjithshëm të NATO-s, Jens Stoltenberg, rreth çështjes së transformimit të FSK-së. Po ashtu, kryeministri Haradinaj ka njoftuar kabinetin qeveritar edhe për pritjen shtetërore që do të organizohet më 14 dhjetor pas kalimit të projektligjeve që ndërlidhen me transformimin e FSK-së.



## Kërkohet që të punohet më shumë në sektorin bankar

PRISHTINË, 6 DHJETOR (ER) - Pavarësisht se zhvillimet dhe përmirësimet e bëra në sektorin bankar gjatë viteve të fundit kanë rezultuar me zhvillim të qëndrueshëm ekonomik në Kosovë, ende duhet të punohet më shumë për ta fuqizuar këtë sektor në aspekt të mbështetjes së sektorit privat dhe implementimit të standardeve të reja në këtë drejtim. Kështu u tha të enjten në tryezën e organizuar nga Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë me guvernatorin e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, Fehmi Mehmeti.

Drejtori ekzekutiv i Odës Amerikane, Arian Zeka, ka thënë se bankat nuk e luajnë vetëm rolin e kujdestarit të pasurive, por edhe të burimit të financimit. Zeka ka deklaruar se bankat në Kosovë kanë luajtur rol të rëndësishëm në fuqizimin e sektorit privat dhe përsheptimin e zhvillimit ekonomik të vendit përmes financimit të prodhimit, tregtisë, ndërtimit dhe, rrjedhimisht, krijimit të vendeve të reja të punës. "Sektori bankar luan rol të rëndësishëm në përmirësimin e qeverisjes korporative dhe ngritjes së cilësisë

së raportimeve të kompanive", është shprehur Zeka. Ai ka përgëzuar edhe Bankën Qendrore të Kosovës për rolin e saj për mbikëqyrjen e sektorit bankar dhe për krijimin e një sistemi të shëndoshë financiar, që përbën jo vetëm shtyllën më të rëndësishme të një ekonomie në zhvillim si rasti i Kosovës, por që ka pasqyruar vendin me tone pozitive nëpër dokumente të rëndësishme ndërkombëtare. Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës, Fehmi Mehmeti, ka deklaruar se zhvillimi i hovshëm i sektorit bankar në vitet e fun-

dit i është atribuar suksesit të zhvillimit të mëtutjeshëm ekonomik në vend. Ai ka thënë se struktura e kreditimit është përmirësuar dukshëm ku rreth 50 për qind kredi të lëshuara u dedikohen ndërmarrjeve në sektorin e tregtisë, duke përmendur rënien e normave të interesit në pothuajse të gjithë sektorët. Mehmeti njoftoi të pranishmit se ndër prioritetet kryesore të Bankës Qendrore të Kosovës janë ruajtja e stabilitetit financiar në këtë sektor, gjithashtu edhe zhvillimi i standardeve bashkëkohore përmes

të cilave bankat në Kosovë do të mund t'i zhvillojnë operimet e tyre në përputhje me vendet e zhvilluara. Guvernatori Mehmeti shprehu gatishmërinë e BQK-së për t'u angazhuar për krijimin e kushteve dhe lehtësirave të cilat do ta mundësojnë mbështetjen e duhur ndaj kësaj fushe, bizneseve dhe zhvillimit ekonomik në përgjithësi. Më tutje, të pranishmit adresuan specifika të ndryshme në lidhje me sektorin bankar të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në zhvillimin e aktivitetit të tyre biznesor.

## Krasniqi: MBPZhr-ja ka ofruar mbështetje të madhe financiare për kultivuesit e pemëve të imëta

PRISHTINË, 6 DHJETOR (ER) - Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZhr-ja) së bashku me USAID-in do ta vazhdojnë mbështetjen e sektorit të mjedrës në vend, me qëllim të zhvillimit të këtij sektori në një industri të qëndrueshme, duke e bërë atë konkurrues në vend dhe rajon. Kështu është thënë të enjten në konferencën e tretë të mjedrës "Të arriturat dhe sfidat e sektorit të mjedrës gjatë vitit 2018", e cila është mbajtur në Prishtinë dhe është organizuar nga Shoqata Nacionale "Mjedra e Kosovës" dhe është mbështetur nga USAID-i, Caritasi zviceran në Kosovë dhe GIZ-i. Gjatë kësaj konference janë paraqitur sfidat e prodhuesve të mjedrës në Kosovë gjatë këtij viti, e të cilat, sipas pjesëmarrësve, po synojnë t'i tejkalojnë nëpërmjet

përvojave dhe praktikave të marra nga ekspertët e huaj të kësaj fushe. Me këtë rast, në fjalimin e tij, zëvendësministri i MBPZhr-së, Mevludin Krasniqi, ka thënë se kjo ministri në vitet e fundit ka ofruar mbështetje të madhe financiare për kultivuesit e pemëve të imëta dhe bimët mjekësore aromatike. Ai ka bërë me dije se gjatë këtij viti MBPZhr-ja dhe USAID-i së bashku janë duke e bashkëfinancuar projektin për pemët e imëta në Kosovë, ku për këtë projekt kjo ministri ka ndarë një buxhet prej tre milionë eurosh, ndërsa USAID-i 4.2 milionë dollarë amerikanë. Ndërsa drejtoresha e misionit të USAID-it në Kosovë, Lisa Magno, ka thënë se gjendja në sektorin e mjedrës ndër vite ka ndryshuar për të mirë falë punës së fermerëve dhe falë mbështetjes që po e japin për zhvillimin e këtij sektori.





# Projektbuxheti për vitin 2019 përkrahet nga pozita, kritikohet nga opozita



Ministri i Financave, Bedri Hamza, ka paraqitur të enjten para deputetëve projektbuxhetin për vitin 2019. Ai ka bërë me dije se me këtë buxhet rritja ekonomike do të arrijë deri në 4.7 për qind. Sipas ministrit Hamza, ky projektbuxhet ofron më të mirat për qytetarët dhe ekonominë e vendit. Projektbuxheti është përkrahur nga partitë në pushtet, kurse është kritikuar për mangësi të shumta dhe orientim të gabuar të mjeteve nga partitë opozitare

**EPOKA  
ERE** Albulena S. MAVRAJ

**PRISHTINË, 6 DHJETOR** - Me debate dhe mospajtime ndërmjet deputetëve të partive në pushtet dhe atyre në opozitë, Kuvendi i Kosovës ka diskutuar të enjten projektligjin për buxhetin e vitit 2019.

Projektbuxheti i parashikuar për vitin 2019 është 2.3 miliardë euro. Nga kjo shifër, rreth 770 milionë euro janë paraparë për investime kapitale. Gjatë prezantimit, ministri i Financave, Bedri Hamza, ka bërë me dije se me këtë buxhet rritja ekonomike do të arrijë deri në 4.7 për qind. Ai ka thënë se ky projektbuxhet ofron më të mirat për qytetarët dhe ekonominë e

Kosovës, duke pasur parasysh nga kufizimet që na imponohen, nga shumë faktorë të brendshëm dhe faktorë të jashtëm. "Ky propozim-buxhet është në linjë me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, duke respektuar rregullën e deficitit buxhetor, rregullën mbi pagat dhe projektuar në nivel adekuat të bilancit bankar", ka deklaruar Hamza, duke shtuar se ky projektbuxhet prioritet i jep sistemit të drejtësisë, arsimit dhe shëndetësisë.

Në bazë të prezantimit është vërejtur edhe rritje e skemave sociale.

Projektbuxheti është përkrahur nga partitë në pushtet, kurse është kritikuar për mangësi të

shumta dhe orientim të gabuar të mjeteve nga partitë opozitare, të cilat janë deklaruar se nuk do ta mbështesin në parim projektligjin e propozuar.

Deputetët e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) e kanë cilësuar projektimin e buxhetit për vitin e ardhshëm nga ana e Qeverisë si buxhet social dhe jo zhvillimor dhe për këtë arsye, thanë se nuk e mbështesin atë. Sipas tyre, Qeveria e Kosovës, në pamundësi të hapjes së vendeve të reja të punës, e ka shndërruar atë në buxhet të blerjes së paqes sociale në vend.

Deputeti i LDK-së, Lumir Abdixhiku, ka thënë ky projektbuxhet e devalvon programin qeverisës pasi, sipas tij, rritja ekonomike në programin qeverisës është proklamuar deri në 8 për qind. Ai ka theksuar se ky buxhet e përgjysmon përparimin në shëndetësi, arsim dhe fusha të tjera. "Për herë të parë në historinë e buxhetit të konsoliduar e deri më sot, kategoria e mbrojtjes sociale është kategoria me pjesëmarrjen më të madhe në buxhet. Plot 21 për qind e buxhetit të vendit apo 465 milionë euro të buxhetit shkojnë për mbrojtje sociale. Për herë të parë kjo kategori e

tejkalon kategorinë e zhvillimit ekonomik. Vetëm këtë vit 88 milionë euro shtohen në këtë kategori. Janë 22 skema sociale aktive në vend dhe të tjera plot në ardhje, të cilat nuk janë parashikuar në këtë buxhet", ka thënë Abdixhiku.

Ndërkaq kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, deputeti Albin Kurti, tha se vërehet rritje e skemave sociale dhe rritje e shpenzimeve buxhetore. Sipas tij, ky buxhet plotëson nevojat e qeveritarëve, po jo edhe të qytetarëve. Në këtë kuadër, ai ka përmendur numrin e madh të të punësuarve në zyrën e kryeministrit dhe shpenzimet e mëdha që nevojiten për këtë zyrë.

Buxheti i vitit 2019 është buxhet i shpenzimit qeveritar dhe jo zhvillimit socio-ekonomik. Është buxhet i shtimit të borxhit publik joproduktiv dhe deficitit buxhetor e që do të gërryjë edhe Fondin e Privatizimit. Numrat e buxhetit janë problematikë, sepse korniza makro-ekonomi, makrofiskale është e gabuar", ka thënë Kurti.

Kurse deputeti nga Partia Socialdemokrate, Dardan Sejdiu, ka paraqitur disa argumente pse kjo parti nuk e mbështet në formën e paraqitur buxhetin për

vitin e ardhshëm. Sipas tij, orientimi i buxhetit është fokusuar në infrastrukturë rrugore, skema sociale dhe jo në zhvillim ekonomik, pasi deficitit tregtar vazhdon të mbetet në proporcion 10 me 1 në favor të importit. Ky fakt, tha ai, në buxhet nuk paraqitet me ndonjë zgjidhje konkrete. "Ky buxhet, sipas PSD-së, vazhdon avazin për trajtimin dhe akomodimin e nevojave të qeverive. Dhe, normalisht, ka shumë vend për sugjerim dhe kritikë. Por, gjithsesi, si konstrukt është i njëjti që kemi parë që 18 vjet, pa marrë parasysh se kush ka qenë në pushtet. Dhe në fund fare mund të konstatojmë se me kësi lloj buxheti ekonomia përfundon këtu qysh është sot, pasi për 18 vjet po e provojmë të njëjtën recetë dhe për 18 vjet, 350 mijë njerëz janë në marrëdhënie pune", ka thënë Sejdiu.

Nëse buxheti nuk votohet, sipas procedurave ligjore në Kuvendin e Kosovës deri më 20 dhjetor, vendi mund të shkojë në krizë buxhetore. Atëherë, sipas afatit kohor, në bazë të Ligjit për menaxhimin e financave, në tre muajt e parë të vitit të ardhshëm shpenzimet buxhetore duhet të realizohen në 1/12 e buxhetit të këtij viti.

# Kërcënimet e Stoltenbergut dhe 'Ekipi i unitetit'!



**Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA**

Strumbullari i botës, Kosova: Pas vendosjes së taksës prej 100 % për mallrat nga dy shtete skajshmërisht armiqësore ndaj Kosovës, Serbisë dhe Bosnjës dhe Hercegovinës, shpërtheu një revoltë ndaj Kosovës dhe Qeverisë së Kosovës, përkatësisht ndaj kryeministrit Haradinaj, duke i akuzuar se po e shkelin CEFTA-n dhe TEFT-në, se po e rrezikojnë dialogun me Serbinë që Kosova ka përfutur nga ky dialog aq sa Ujëvara e Mírushës nga shkrija e borës në Himalaje. Myftiu i Bosnjës e dërgoi një kërkesë moralizuese, e mbështjellë me arsyetim politik, për heqjen e taksës nga e cila Bosnja humbet afërsisht 156 milionë euro në vit. Pastaj, Serbia po ankohet në tërë botën shkaku se nga malli i dyshimtë përfiton së paku 600 milionë në vit, në mos edhe më shumë përmes tregtarëve të pashpirt, të pandjenja dhe të pamëshirshëm shqiptarë dhe të cilët e kanë ngritur perandorinë tregtare të Serbisë në Kosovë duke pastruar paratë e pista të Mishkoviqit, Dodigut dhe vëllait të Aleksandar Vuçiqit, kryetarit aktual të Serbisë, me një të kaluar kriminale për krime lufte. Tash edhe këta që skajshmërisht na kanë kufizuar lirinë e lëvizjes, pa të drejtë, burokratët e BE-së, me gënjeshtarët Mogerini dhe Han, fort po bregosen për afërsisht një miliard euro që i humbin Serbia dhe Bosnja në Kosovë për shkak të taksës për mallra nga këto dy shtete armiqësore ndaj Kosovës duke kërcënuar për marrje të masave ndëshkuese ndaj Kosovës sikur që është pezullimi i vizave Shengen për Kosovën, mbylljen e tregjeve botërore ku Kosova shet me qindra miliardë euro dhe dollarë, pamundësia e qasjes së Kosovës në bursat botërore si Wall - Street, p. sh., ku Kosova qarkullon 50 miliardë euro dhe dollarë brenda ditës, ndalimi i eksportit të naftës nga Kosova në vendet e tjera ku Kosova eksporton miliona e miliona barele naftë të papërpunuar dhe ku rafineritë në Kosovë përpunojnë miliona

fuqi karburante, pamundësimi i Kosovës për pjesëmarrje në tregjet botërore për diamant ku Kosova ka monopol absolut, pengimi i eksportimit të uranimit të pasuruar dhe armëve nga Kosova, sidomos në Arabinë Saudite, ku Kosova eksporton së paku 100 miliardë armatim brenda një viti, bllokimi i gazsjellësit përmes linjës LLAP (Llapushnik), konkurrense e linjës TAP, nga Kosova për shtetet e BE-së për shkak të luftës në Ukrainë sikur edhe pezullimi i anëtarësimit në Paktin NATO, ku Kosova është kryesuese e këtij Pakti dhe vetëm me votën e Kosovës z. Stoltenberg është zgjedhur sekretar i Paktit NATO. Nga përvoja flas se gjithmonë atij që i ke ndihmuar, ta kthen me të keq! Shembull më konkret se rasti Stoltenberg nuk mund ta gjeni; në përpjekje të Kosovës për ta forcuar pakëz segmentin për raste emergjente e që quhet FSK (Forca e Sigurisë së Kosovës), sekretari Stoltenberg dërgoi Kërcënimin e Kërshëndellave (të dhjetorit) se, nëse Kosova e bën transformimin e FSK-së në Forca të Mbrojtjes së Kosovës, atëherë NATO-ja do të ndërmerë veprime kundër Kosovës duke injoruar faktin se NATO pa Kosovën është si Kazanova pa gjenitale dhe se as Stoltenbergu kurrë nuk do të zgjidhjet jo sekretar, por as kamerier i Paktit NATO pa pajtimin dhe votën e Kosovës. Stoltenbergu deklaroi se nuk është kohë e përshtatshme për këtë transformim ani pse janë bërë thujja 20 vjet nga përfundimi i luftës në Kosovë pas së cilës UÇK-së i janë marrë edhe pushkallat që nuk do t'i pranonte as Muzeu i Njohur Botërorë në Muçiverc, kurse Serbia po armatohet me armatimin më modern nga Rusia e Putinit dhe Kina e Ho shi minit. Serbia po prodhon armatim që po e shet në Afrikë dhe me këtë armatim po e blenë votën e shteteve për të mos e njohur Kosovën apo për ta siguruar ç'njohjen. Me këto armë po e pengon anëtarësimin e Kosovës në organizata ndërkombëtare dhe këtë po e bën për normalizim të marrëdhënieve me Prishtinën, kurse NATO-ja dhe këta mashtruesit e Brukselit, çil gur gojën, sikur peshqit e Istogut! Ku dhemb dhëmbi, shkon gjuha dhe Stoltenbergu tha se NATO-ja është kundër taksës 100 % shkaku se pengon vazhdimin e bisedimeve për normalizim të marrëdhënieve shumë nor-

male midis Vuçiqit dhe Thaçit! Stoltenbergu nuk i ka mbetur asgjë tjetër përveç se t'i shpallë luftë Kosovës dhe në këtë pikë nuk dallon aspak nga Vuçiqi, kryetar i Serbisë, Burri i Fortë i Serbisë, Jasna Bërnabiq, kryeministre e Serbisë, Ivica Daçiq dhe Vulin, ministra të Serbisë si dhe Marko Gjuriq, Karagjorgji i Serbisë. Realisht, luftën me Kosovën e pati filluar Marko Gjuriq i cili me një blic - krig (pordhë e vogël) erdhi deri në Qendrën e Ndalimit në Prishtinë e që pastaj u transportua, pasi i kishte kryer të gjitha proceset fiziologjike në brekë dhe në automjetin e Policisë së Kosovës deri në Merdare për të vazhduar me betejat e tjera! Vuçiqi thotë se, nëse Kosova e formon ushtrinë, atëherë si opsion mbetet intervenimi ushtarak i Serbisë në Kosovë për t'i mbrojtur serbët e Kosovës nga Radojçiqi, Rakiqi, Simiqi, Maksimoviqi, Millosavleviqi dhe nga njësjia paramilitare e quajtur LS. Radojçiqin besoj se shumë shpejt Vuçiqi do ta dërgojë në parajsë duke e bërë pjesë të "nebeski narod" apo "popullit hyjnor" ku e pret edhe Oliver Ivanoviqi të cilin, Vuçiqi, bashkë me Radojçiqin, e dërguan më herët dhe me një procedurë të përsheptuar në parajsën e premtuar. Burri i Fortë i Serbisë, Jasna Bërnabiq po thotë se opsionin e luftës e kanë në tavolinë, kurse Sheshelit, meqë i është lodhur bytha dhe nuk ia mbanë, për intervenim në Kosovë thërret Rusinë dhe Kinën. Vulini është gjithmonë i mobilizuar sikur edhe Daçiqi, kurse Marko Gjuriqi përfundimisht nuk do të jetë në vijën e parë të frontit, me dëshirë do të qëndrojnë në prapavijë, si përkrahje logjistike.

Lexues të nderuar, ju që jeni më të mëdhenj në moshë dhe që keni lexuar për të kaluarën e idhullit të këtyre luftënxitësve, kriminelit Millosheviq, a mund ta gjeni një dallim midis retorikës luftarake të Millosheviqit në Gazimestan, i shoqëruar nga Azemi i Kosmetit, dhe retorikës së Gardës aktuale kriminale politike që udhëhiqet nga gjenerali Vuçiq dhe Vojvoda Sheshel?! Sigurisht se jo sepse nuk ka fare dallim! Madje, nëse analizohet konteksti kohor dhe politik, deklaratat e Millosheviqit në Gazimestan është më e lehtë se deklaratat e gjeneral Vuçiqit, Burrit të Fortë të Serbisë, Jasna Bërnabiq, pordhaxhiut Marko Gjuriq dhe Vojvoda Sheshelit!

Stoltenberg, me dashje ose pa dashje është në këtë linjë sepse kërcënimet që i bënë Kosovës nuk janë aspak më të buta se këto që vijnë nga Serbia! Nuk mund të besohet se një shtet që rrethohet me një shtet aq armiqësorë sikur që është Serbia dhe i cili vazhdimisht kërcënon me luftë në kohën që dhunën ndaj Kosovës dhe ndërhyrjen flagrante në punët e brendshme të Kosovës e ka legalizuar duke e noterizuar te Mogerini dhe Han dhe me dëshmitarë kyç Putinin dhe Stoltenberg, privohet nga e drejta e ligjshme dhe e Zotit për të formuar një mekanizëm mbrojtës, siç po veprohet me Kosovën. Kosova nuk është shtet dhe vend sikur që është Vatikani dhe të cilit i mjafton roja e Gardës Zvicerane që, më shumë si ritual se që është nevojë e mbrojtjes Papë Françeskun. Le ta krijojë NATO dhe BE një ambient paqësorë rreth Kosovës sikur që e ka Vatikani dhe Kosova nuk do të ketë nevojë për ushtri! Kështu, në kohën kur shumë oborre dhe parqe në Serbi janë me eshtra të shqiptarëve nga Kosova, kur gjeneralët e Serbisë të dëshmuar për krime lufte në Kosovë ligjërojnë në akademinë ushtarake të Serbisë për ndërtim të paqes e me të cilët NATO, përmes KFOR-it, ngushtë ka bashkëpunuar pas përfundimit të luftës, me Sheshela, Dikoviq, Pavkoviqa, Vuçiq, Daçiq, Vulina, Lajiq, ku kriminelët serbë kanë bërë kupa për të pirë raki nga kafkat e shqiptarëve të ekzekutuar, ku nga po këto kafka bëjnë llapma ndriçuese, ku dhunimin e femrave shqiptare duan ta materializojnë përmes video - klubeve, ku kur edhe ata që marrin rrogë nga Buxheti i Kosovës thërresin: "Kosovo je Serbia - Kosova është Serbi", ku na detyrojnë për më shumë se 10 vite t'ua paguajmë rrymën dhe shërbimet tjera dhe shumë të tjera. Realisht, këto edhe mund t'ua falim disi po si mund ta përballojmë faktin që këta serbë nuk e njohin Agim Bahtirin për kryetar të Mitrovicës dhe si nuk po e përkrahin idenë gjeniale të gjenialit Agim që Shaqira, nga Kolumbia e Marecit, me përcjellje të defave dhe tupanëve, të hapë urën duke vallëzuar Zhikino Kollo dhe duke kënduar ur himnin; "Ko to kazhe, ko to llazhe, Serbia je malla..." - kush thotë dhe kush gënjen se Serbia është e vogël! Kjo, jo që nuk mund të pranohet por as që mund të durohet dhe, pikërisht

shkaku i mospërfilljes së idesë gjeniale të Agim Bahtirit, nga një parti 100 % kombëtare - AKR (A i ke rruajtur t...)! është arsye e mjaftueshme që Kosova t'i shpallë luftë Serbisë. Në fund, z. Stoltenberg, a keni mungesë të informatave që kërcënoni aq paturpësisht apo keni vendosur që pas përfundimit të mandatit të sekretarit të NATO-s, të rreshtoheni në armatën e Vuçiqit dhe Burrit të Fortë të Serbisë, Jasna Bërnabiq, si snajperist i Vojvoda Sheshelit, pasi ta fillojnë luftën në Kosovë?! Nuk po gjejë arsye të mendoj ndryshe, pas kërcënimit publik që e bëni!

Ekipi i Ç'unitetit: Këto partitë politike në Kosovë fort po e nënçmojnë Hashim Thaçin, duke menduar se e pati puna e tij dhe se së shpejti do të ikë përlesh! Më shumë po i gëzohen faktit se Hashim Thaçi mund të keqtrajtohet nga Gjykata Speciale, se vetë Serbia, se vetë kryeprokurori i kësaj Gjykate dhe se vetë shkruesi i aktakuzave kundër UÇK-së dhe disa udhëheqësve të saj, miku i ngushtë i Karla del Pontes, që do të vdesë pa e kapur Gjarprin, Dik Marti! Unë personalisht nuk do ta doja fundin që do ta ketë Hashim Thaçi as për Dik Martin e lëre më për Kara del Ponten. Secili është shkruesi i fatit të vet dhe fatin e askujt nuk mund ta shkruajnë të tjerët. As fatin e presidentit Legjendar, Madhështor, Tarak, Dinak, Dhëparak, Spirituoz, Filozofik etj. dhe shumë të tjera, për të cilat, në mungesë të kapacitetit intelektual (shihe ti, intelektual) nuk po gjej fjalë e as shprehje. Luan Shllaku, një njohës i shkëlqyer i politikave mjedisore e sidomos partizan i bindur kundër ndotjes së mjedisit, ka hyrë në një mjedis edhe më të ndotur, mjedisin e ndotjes së karakterit, ndërjegjes dhe vetëdijes të një grupacioni të caktuar e që ka pretendime se merren me politikë! Për këtë arsye dhe për të krijuar një garë të barabartë, me vete e ka marrë një "kalë" tashmë të rraskapitur dhe të lodhur për faktin se ka marrë pjesë në çdo garë kuajsh dhe gomarësh, që nga viti 1990 e deri më tani. Dhe i cili asnjëherë nuk e ka çuar garën deri në fund por është dorëzuar apo tërhequr, para mbarimit të garës. Pretendimet janë të çarta; me një alkimi ta shndërrojë Gjarprin në hardhucë pa dhëmbë! E që nuk mund t'ia dalin kurrë sepse Hashim Thaçi nuk i ka nënshkruar librat

fenomenalë të autorëve më të famshëm botërorë për të e që Veton Surroi ta bëjë nënshkrimin e fundit! Për Hashim Thaçin, pa asnjë dyshim do të bëhen filma, edhe nga Hollivudi, edhe nga Bollivudi. Kur janë bërë filma për Pablo Eskobarin, pse të mos bëhen edhe për Hashimin! Hashim Thaçi nuk e ka problem Veton Surroin dhe Ekipin e Ç'unitetit. Ata i hanë në vend të kallamarit, kur ka mungesë në treg! Madje për ta as që shpenzon verë Curva Italiana por vetëm rasoje t'Burojes! Hashim Thaçi nuk e ka problem as LDK sepse, gjithmonë mund ta riciklojë Alma Lamën. Hashim Thaçi nuk e ka problem as LV-ja e cila, në çdo përvjetor organizon protesta kundër Hashimit pas së cilave gjashtë muaj bënë analiza se sa vet kanë marrë pjesë në protesta dhe se a do ta kalojë pragun zgjedhor PSD! Hashim Thaçi nuk e ka problem as PDK sepse, një numër të deputetëve të kësaj partie, i mbanë në grusht, në vend të ko...! Hashim Thaçi nuk e ka aspak problem shoqërinë civile për faktin se ka shoqëri të madhe civile dhe jovicile me Batonin dhe disa kondom gazetarë, apo kurtizana shoqëruese. Aktualisht, të vetmin problem që e ka Hashim Thaçi është Ramush Haradinaj, që nuk i përputhet në skenarin e shkruar nga të tjerët, me artistë të pashkolluar, Aleksandar Vuçiq dhe vet Hashimi. Më herët, po ta largonte Ramushin, Hashimi do të kishte më pak vuajtje dhe dhimbje! Tash e ka shumë vështirë ta kapërdijë Ramushin për faktin se Ramushi është rritur shumë. Është rritur thuhet 100 %. Hashimi po bënë përpjekje t'ia lëshojë Ramushit në kurriz Mogerinin, Hanin, Stoltenbergun, Boltonin dhe Makronin. Sa për fillim dhe, nëse nuk riformatizohet, atëherë do ia lëshojë një kalibër më të madh, nëse deri atëherë do të mbijetojë edhe vetë Hashimi!

Hashim Thaçi as që e lodhë mendjen gjeniale për Vetonin apo Shpendin. Vetonin e ka dribluar dhe punuar shumë herë më parë kurse Shpend Ahmeti nuk është Mehmet Shpendi, nuk e bën hesap as për një sorrë. Ky Ekip që po bënë përpjekje të formohet do të jetë mbështetja më e madhe për Hashimin dhe Hashimi, vetëm për shkaqe taktike sepse nuk ka nevojë të përdorë ndonjë strategji të specializuar, e ka penguar që të votohet në Kuvend! Jo se ndjehet i rrezikuar nga ky grup. Hashim Thaçin nuk e mbrojnë këta eunuh këshilltarët, me të kaluar jugosllave por edhe denoncuese (i kanë denoncuar të burgosurit politikë), të pakurizizë dhe të padenjë për të punuar

edhe në klubin Cobra City dhe të cilët janë të kastruar nga çdo përgjegjësi dhe ndjenë kombëtare. Hashim Thaçi e ka një xhoker të jashtëzakonshëm, një njeri të madh, një patriot dhe kombëtar të përmasave më të mëdha se vet Hasan Prishtina. Një idealist i idealistëve dhe një materialist mbi të gjithë hajdutët e botës. Një Ismail Qemal që, më 28 Nëntor 2018, në Vlorë, i fshehur pas prapanicës bukur voluminoze të Edi Ramës dhe prapanicës së ngjeshur me muskuj që ia rrudhin pjesën më të ndjeshme të burrisë, asaj të Ilir Metës, e nderoi duke qëndruar gatitu flamurin e Kazakistanit e që e shkaktoi entuziazëm të madh në mesin e kosovarëve dhe orgazmën e Hashimit. Hashimi është gjenial në përzgjedhje ndryshe, ma gjeni një njeri tjetër që ka koçe dhe guxim ta dërgojë Behgjet Pacollin në Sheshin e Pavarësisë në Vlorë! Çfarë ndjenje patriotike na ngjalli Begja! Serioz dhe dinjitoz, përfaqësues dhe inspirues! Hashim Thaçi është alkimisti më i zoti i ditëve tona, më i zoti se Alkimisti i Paolo Koelhos. Alkimisti i Koelhos nuk shkoi përtej përpjekjes për eksperimentim, alkimisti Thaçi eci shumë para, m.in e bëri mjaltë, antipatriotin e bëri patriot dhe, që ende nuk është bërë publike, Luginën e Preshevës po e bënë Anamoravë! Pa i dhënë asgjë Serbisë.

Hashim Thaçi as që mendon për Ekipin e Unitetit! Ai po konsultohet me disenjatorin personal të modës së çfarë kostumi do të veshë në ceremoninë e ndarjes së Çmimit Nobel. Nëse për të shkruhen edhe nja dy-tre libra atëherë ka gjasa ta fitojë Çmimin Nobel për Letërsi ose, më së paku për faktin se po e bashkon Luginën e Preshevës do ta fitojë Çmimin Nobel për Paqe. Mund të ndodhë që t'ia fitojë të dyja këto çmime. Pas përfundimit të Konferencës së AVNOJ-it, në Jajce (përkthimi shqip i bie bol...), përfaqësuesi i Bosnjës dhe Hercegovinës kërkoi të dijë se çka fiton Bosnja pas kësaj Konference duke kërkuar sqarim nga Mosha Pijade. Mosha Pijade si çifut dhe cinik i përgjigjet: "Jajcen (bol...) e majtë e fiton Kroacia, të djathtën e fiton Serbia dhe Bosnja e fiton atë çka mbetet në mes, pas largimit të bol...!"

Duhet të jeni budalla e të besoni se Hashimi që e ka vendosur topin në penalti, me portier nga radhët e PDK-së, do të lejojë që Veton Surroi apo Behxhet Shala të shënojnë. Unë mund të jem një lloj budallai e që në fakt edhe jam por jo aq i madh sa të besoj këtë. Ose do të bëhet 100 % siç thotë Hashimi ose 100 % do ta hajë Hashimi! Ta shohim. Ora po ecën shpejt!



## Familja Hazrolli nga Banja i bëri me shtëpi dy familje nga Malisheva

**MALISHEVE, 6 DHJETOR (ER)** - Dy familje nga Malisheva janë bërë me shtëpi falë humanitetit të familjes së Ali Hazrollit nga Banja e kësaj komune. Në ceremoninë e dhënies së çelësave të shtëpive për familjet e Mefail Kastratit nga Maxharra dhe të Amrush Zogajt nga Lladroci, ka marrë pjesë edhe kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, i cili i ka falënderuar familjen Hazrolli për këtë veprim, ndërsa dy përfituesit i ka uruar për shtëpitë e tyre. "Ju jemi shumë mirënjohës kësaj familje, e cila, krahas kontribu-

tit në luftë, edhe sot po vazhdon të kontribuojë me këtë formë të ndihmës për familjet në nevojë. Po ashtu, falënderoj edhe mërgimtarët tanë, siç është Burim Hazrolli, që ka marrë këtë iniciativë që t'i ndërtojë këto dy shtëpi. Zoti i shpërbleftë të gjithë ata që kanë mundësi t'i ndihmojnë këto familje", ka thënë Begaj.

Po në këtë ceremoni ka marrë pjesë edhe anëtari i familjes Hazrolli, gjeneralmajor Gëzim Hazrolli, i cili ka ftuar të tjerët që kanë mundësi të jenë solidarë me familjet në nevojë.

"Është ndjenjë e veçantë kur ke mundësi ta ndihmosh një familje në nevojë, si familja Kastrati, apo edhe të një veterani siç është familja e veteranit Amrush Zogaj. Mendoj se secili që ka mundësi duhet të ndajë nga pak nga të mirat materiale dhe t'i ndihmojmë ata që kanë nevojë, pasi e kemi obligim dhe t'u ofrojmë pak ngrohtësi. Shteti nuk ka mundësi që t'i ndihmojë të gjitha rastet, por duhet të jemi solidarë të gjithë dhe me bashkimin e forcave, çdo familje mund të ndihet mirë", ka thënë Hazrolli.



## Latifi vizitoi punimet në dy projekte infrastrukturore në qytetin e Rahovecit

**RAHOVEC, 6 DHJETOR (ER)** - Kryetari i Komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, i shoqëruar edhe nga nënkryetari Fatmir Iska, kanë vizituar punimet të cilat janë duke u realizuar në dy projekte infrastrukturore në qytetin e Rahovecit si projekti i rrugës transite dhe shtegu i ecjes që dërgon te Maja e

Shkodranit. Pas vizitave të bëra në të dy projektet të rëndësishme infrastrukturore, kryetari Latifi ka theksuar se punët në infrastrukturë nuk po ndalen në këtë komunë. "Monitorova punimet që po kryhen në rrugën e transimit mbi qytet si dhe në shtegun e ecjes, projekte këto të rëndësishë

së veçantë për qytetarët tanë. Shumë shpejt Rahoveci do të bëhet me një shteg modern e të bukur, ku qasja për në Majën e Shkodranit do të bëhet më e lehtë e njëkohësisht pamja që qytetarët do të shijojnë në këtë ecje do të jetë e mahnitshme", ka thënë kryetari Latifi.

**Ministri Gashi: Kulla e Azem Galicës do të ketë përkujdesje shtetërore**

PRISHTINË, 6 DHJETOR (ER) - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS), Kujtim Gashi, ka paralajmëruar se shumë shpejt


Kulla e Azem Galicës do të jetë nën përkujdesjen e shtetit si dhe do të jetë e hapur për vizitorë. "Bashkë me gjeneral Sami

Lushtakun vizitova kullën e trimit të Drenicës, Azem Bejtë Galicës, ku premtova se së shpejti do të intervenojmë që kjo

kullë të ketë përkujdesje shtetërore dhe të jetë e hapur për vizitorë", ka shkruar Gashi në llogarinë e vet në "Facebook".



# Vdekja e Kristian Gytit, humbje e madhe për kulturën shqiptare



Rexhep QOSJA

U nda nga jeta albanologu Kristian Gyt.

U nda nga jeta në moshën 87-vjeçare, duke mbetur i përjetshëm dhe i lavdishëm në historinë dhe kulturën shqiptare. Studiuesit e shquar Remzi Përnaska dhe Enver Hysa kanë sjellë shumë të dhëna për jetën e tij, për natyrën e tij, për krijimtarinë e tij shkencore, për angazhimet e tij të gjithanshme kulturore, shoqërore dhe institucionale, në përgjithësi për përkushtimet e tij ndaj tyre dhe mendore.

Prej këtyre të dhënave shihet se Kristian Gyt ka qenë ose drejtues,

ose pjesëmarrës i shumë institucioneve, i shumë organizatave dhe i shumë shoqatave të Francës, në të cilat është punuar dhe punohet për historinë e Shqipërisë e të popullit shqiptar, për kulturën dhe qytetërimin shqiptar.

E gjithë përmbajtja e veprimtarisë dhe e krijimtarisë së tij të gjatë, shumëvjeçare, që përbën qëllimin kryesor të studimeve të tij të gjithanshme, janë historia, gjuha, zakonet, traditat, folklori, letërsia e popullit shqiptar.

Kristian Gyt ishte një prej njohësve më të mirë dhe një prej trajtuesve më të gjithanshëm të gjithë atyre vlerave që përbënin të kaluarën dhe të atyre që përbëjnë të përtashmen shpirtërore shqiptare.

Për shkak se e ka njohur aq gjithanshëm dhe e ka trajtuar aq përkushtueshëm historinë e popullit shqiptar, për shkak se e ka njohur dhe e ka trajtuar aq gjithanshëm krijimtarinë e tij

shpirtërore, Kristian Gyt e ka dashur popullin shqiptar.

Dhe, për shkak se e ka dashur aq përkushtueshëm popullin shqiptar, ai ka marrë pjesë me punë, me veprimtari shoqërore dhe kulturore, me studime shkencore kudo është folur për të: në tubime të ndryshme, në sesione, në simpoziume, në konferenca e në kongrese shkencore albanologjike, ballkanologjike, evropiane e botërore.

Për shkak se e ka dashur aq përkushtueshëm popullin shqiptar ai e ka përkthyer "Kanunin" e Lekë Dukagjinit. Dhe, për të njëjtat arsye, ai ka përkthyer vepra letrare, studime dhe trajtesa shkencore të autorëve shqiptarë.

Sa shumë të dhënat e reja, sa shumë gjykimet e reja, sa shumë vlerësimet e reja janë të përmbajtura në studimet dhe në përgjithësi në shkrimet e në ligjëratat e tij për historinë shqiptare, për gjuhën shqipe, për

zakonet, adetet, kanunet, në përgjithësi për krijimtarinë shpirtërore të popullit shqiptar.

Është dukshëm e qartë se Kristian Gyt ka shkruar shumë në sasi e me shumë cilësi për ne, për shqiptarët, por ne jo sa duhet dhe sa e ka merituar kemi shkruar e bërë për të.

Shumësia e lëndëve, e temave, e çështjeve, e problemeve që ka trajtuar ai në studimet e veta shqiptare ka merituar shumë më tepër kujdes, paraqitje dhe popullarizim prej nesh.

Përkushtimi yni si popull e si shtete ndaj gjithë veprimtarisë së tij, ndaj gjithë krijimtarisë së tij mendore, ndaj gjithë studimeve të tij shqiptare nuk do të ishte vetëm shprehje e nderimit tonë për të, për Veprën e tij të madhe albanologjike, por edhe nevojë mendore dhe morale e kohës sonë për atë Vepër e për atë intelektual francez, evropian, botëror.

Studiuesit e historisë dhe kulturës shqiptare si Kristian Gyt, miqtë e

përkushtuar si Kristian Gyt, albanologët e shquar si Kristian Gyt gjithmonë e kanë nderuar dëshmueshëm dhe gjithmonë e kanë dashur dëshmueshëm popullin shqiptar me dhembjet, me idealet e me të arriturat e tij. E duan, natyrisht, dukshëm dhe sot.

Nderimi ynë për ta, përkushtimi ynë ndjenjor e mendor ndaj tyre duhet të jetë gjithnjë e më i dukshëm, më mbarëkombëtar.

Për të gjitha arsyet e sipërthëna nderimi ynë, kujtimi ynë për albanologun e madh, për mikun tonë të madh Kristian Gyt do të jetë i përjetshëm. I përjetshëm dhe i dëshmuar me përkushtime konkrete historike, shkencore, shtetërore.

Me familjen e tij, me miqtë, bashkëpunëtorët dhe me të gjithë ata që e kanë dashur e çmuar, unë, si mik dhe adhurues i Veprës së tij, i Etikës së tij intelektuale, ndaj dhembjen dhe pikëllimin.

Prishtinë, 5. 12. 2018

## Lahuta e Serbisë? Lahutari mes lotësh: Ja dhamë vetë, s'e grabitën!



Lahutari i vjetër i malësisë Jonuz Delaj. I prekur emocionalisht pas vendimit të UNESCO-s për ta regjistruar lahutën si pasuri kombëtare të Serbisë, Jonuzi nuk mundi t'i ndalte lotët.

Ai rrëfeu se lahuta ka qenë pjesë e pandarë e jetës së tij, e trashëguar brezi pas brezi nga familjarët si një vegël muzikore që i jep identitet dhe përfaqësi popullit shqiptar.

Teksa moderatorja e ngacmoi

për t'i kërkuar një mendim të sinqertë rreth vendimit të marrë nga UNESCO, i prekur, lahutari tha: "Lahutën ja u dhamë vetë, nuk na i grabitën", duke e lënë përgjegjësinë te institucionet shqiptare përkatëse.

Ndërkohë, studiuesi i njohur Sokol Shupo që po ashtu ishte pjesë e debatit për vendimin e UNESCO-s lidhur me lahutën, tha se kjo është një çështje, ku fitues janë ata që llojnë dhe

janë aktiv, e në rastin konkret serbët kanë punuar për të realizuar atë që donin.

Nga ana tjetër Shupo ka fajësuar Ministrinë tonë të Kulturës dhe të gjitha institucionet e tjera përkatëse, që nuk kanë bërë mjaftueshëm.

"Se kemi këtu ca njerëz që nuk kanë asnjë lloj vizioni, asnjë lloj formimi apo informacioni që ta bëjnë këtë punë tamam, nuk na e ka fajin njeri", është shprehur ai. (gazeta-Shqip.com)

## Kalaja e Beratit, mbi 128 mijë vizitorë zbuluan historinë mbresëlënëse

BERAT, 6 DHJETOR - Kalaja e Beratit është një nga atraksionet turistike më të vizituara ku çdo vit e më shumë tërheq vëmendjen e turistëve të huaj

dhe shqiptarë. Kalaja e Beratit mirëpriti 128 216 vizitorë të cilët erdhën dhe zbuluan historinë e papërsëritshme të një qyteti mbresëlënëse për periud-

hën janar-nëntor 2018. Kalaja e Beratit është një nga monumentet më të mëdha historike të Ballkanit, një fortesë e madhe që sundon mbi lumin

Osum. Kalaja është ngritur sipas një plani në formë trekëndëshi. Kjo kala, po të shihet nga poshtë, duket si pjesë e kodrës.




## Ariana Grande tregon pse ka qenë në lidhje me shumë meshkuj të famshëm



**A**riana Grande ka folur për lidhjet e saj të dashurisë, me meshkuj të famshëm. Ylli 25-vjeçar i muzikës pop që është zgjedhur "Gruaja e Vitit" nga revista Billboard ka folur për revistën për lidhjet e saj të dashurisë, me meshkuj të famshëm, dhe se si ata e kanë

inspiruar ata për muzikën e saj. "Kjo është mënyra se si unë i takoj njerëzit. Nuk mund thjesht të shkoj në bar dhe të takoj dikë. Unë kam një jetë shumë dinamike, bëj gabime, mësoj nga to dhe jam mirënjohëse për çfarëdo që ndodh", ka thënë Grande duke folur për ish të dashurit e saj.

## Khloe Kardashian dëshiron edhe një fëmijë me Tristan Thompson



**T**etë muaj pasi Khloe Kardashian ka mirëpritur vajzën True me Tristan Thompson, ajo dhe 27-vjeçari basketbollisti i Cleveland Cavaliers, janë duke provuar që të kenë edhe një fëmijë. "Ajo nuk është

shtatzënë për momentin, por ata janë duke provuar edhe për një fëmijë tjetër, në mënyrë aktive. Khloe thjesht e pëlqen të qenit nënë. Ajo dëshiron që True të ketë një vëlla ose motër", ka thënë një burim për revistën "Us Weekly".




## Rita Ora sërish me veshje unike në Kaliforni

**R**ita Ora sërish është shfaqur unike në rrugët e Kalifornisë. Këngëtarja 28-vjeçare kishte

të veshur një kostum shumë të veçantë. Njëra anë ishte ndryshe nga ana tjetër.

## Kevin Hart do ta udhëheqë 'Oscars 2019'



**K**evin Hart do ta udhëheqë 'Oscars 2019'. Aktori 39-vjeçar do ta drejtojë për herë të parë këtë ceremoni madhështore, raporton "THR". Ai pati thënë publikisht se e do këtë gjë. "Kjo do të ishte një arritje e madhe. Me atë që kam bërë dhe progresin që kam

bërë në karrierën tim, ky është një hap padyshim i madh", kishte deklaruar Kevin në vitin 2015. Kevin më parë drejtoi MTV Movie Awards me Dwayne Johnson. Akademia ka premtuar se ceremonia e 2019-s nuk do të zgjasë më shumë se tri orë.

**E jashtëzakonshme**


## Japonia po dhuron shtëpi falas

Japonia njihet si një vend me një popullsi gjithmonë në ulje. Së fundmi është konstatuar se shumë shtëpi kanë mbetur boshe, pasi pjesa më e madhe e grupmoshave të reja po synojnë që të jetojnë në qytete, kësh-tu vendet rurale po boshatisen. Rreth 900 fshatra mendohet se do të zhduken deri në vitin 2040. Kështu Japonia ka vendosur t'i



dhurojë shtëpitë e boshatisura falas. Përfituese e parë ishte familja e Naokos.

**FOTO E DITES**



George W. Bush shpërthen në lot derisa i jep lamtumirën babait tij, ish-presidentit George H. W. Bush /EPA

**E rrallë**

## Motoçikleta elektrike që kushton mbi 100 mijë dollarë

Kompania ARC me qendër në Britani bëri të njohur në Milano modelin e parë të një motoçiklete që është përshkruar si e shpejtë, e avancuar dhe e kushtueshme. E quajtur "Vector", motoçikleta kushton më shumë se 100 mijë dollarë. Prodhuesit e motoçikletës së kushtueshme elektrike thonë se është teknologjikisht më e avancuara në treg.



Themeluesi i kompanisë ARC, Mark Truman, shpjegon arsyen. "Është më e sigurt, më miqësorja me mjedisin, më e qëndrueshmja. Ka ritmin e një super-motoçiklete".

**BARSOLETA E DITËS**



**Dy shoqe:**

- Po diskutonin dy shoqe. E para i thotë të dytës:
- Mua më kanë kërkuar 100 herë për t'u martuar.
- Ashtu?! E kush?, e pyet e dyta.
- Prindërit e mi.



**Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC**

**"ALPHA" 3D,**

Aventure/Drame/Familjar; 1 ore 36 min

Rolet: Kodi Smit-McPhee, Jóhannes Haukur Jóhannesson  
Regjia: Albert Hughes

Vetëm gjatë vikendit në ora 14:00



Në ora 16:00

**"JOHNNY ENGLISH STRIKES AGAIN"**

Aksion/Aventure/Komedi; 1 ore 28 min

Rolet: Rowan Atkinson, Olga Kurylenko, Emma Thompson, Ben Miller, Miranda Hennessy, Jake Lacy, etj.  
Regjia: David Kerr



Në ora 18:00

**"NIGHT SCHOOL"**

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Kevin Hart, Tiffany Haddish, Rob Riggle, Taran Killam, Romany Malco, etj.  
Regjia: Malcolm D. Lee



Në ora 20:00

**"SIBERIA",**

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Keanu Reeves, Ana Ularu, Pasha D. Lynchnikoff, James Gracie, Eugene Lipinski, Rafael Petardi, Veronica Ferres, Molly Ringwald, etj.  
Regjia: Matthew Ross



Në ora 22:00

**"VENOM" 3D,**

Aksion/Horror/Fantastiko-Shkencor; 1 ore 52 min

Rolet: Tom Hardy, Michelle Williams, Riz Ahmed, Scott Haze, Reid Scott, etj.  
Regjia: Ruben Fleischer  
Based on the Marvel Comics



**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**




**DASHI**

Sot do të pendoheni për disa shpenzime të bëra kohët e fundit sepse po shikoni që nuk i keni pasur fare të nevojshme.



**DEMI**

Të gjithë ju që keni mjaft kohë në dispozicion duhet të filloni të merreni me aktivitete fizike. Dita do të kalojë shumë me këndshëm dhe në harmoni me të tjerët.



**BINJAKËT**

Keni përkrahjen e miqve tuaj në çdo hap që doni të bëni. Ndryshime të mëdha parashikohen për ju dhe jeni stepur disi nga e panjohura.



**MËNDJA**

ju rri vetëm tek momentet e bukura. Shumë shpejt do të duhet të ktheni me këmbë në tokë se dita është mjaft e ngjeshur.



**LUANI**

Jeni tipa të pavarur dhe do ta shprehni mendimin tuaj edhe me kosto të lartë nga mbrapa. Kufizimet dhe kornizat nuk janë në stilin tuaj.



**VIRGJËRËSHA**

Edhe pse se fundmi nuk keni mjaft ndërveprim me partnerin kjo gjë nuk ju pengon të bëni plane bashkë. Ndihehi të dy të lodhur nga rutina.



**PESHORJA**

Nëse doni të debatoni me dikë është mirë që ta bëni për situata të se tashmes dhe jo duke sjellë në valle të shkuarën e gjithsecilit.



**AKREPI**

Sot ju ka pushtuar një xhelozi e pashp-jegueshme që do të ketë pasoja jo të mira në lidhjen tuaj. Do të merrni të mirëqenë çdo gjë që do ju thuhet.



**SHIGJETARI**

Mjaft entuziastë sot në çdo gjë që do t'ju komunikohet. Ndihehi si fëmijë që po i dhurojnë një lodër që mezi e prisnit dhe doni ta eksploron.



**BRICJAPI**

Kujdes me hapat e gabuar sepse mund t'ju çojnë në një rrugë pa krye. Ndonjëherë bëni mirë të kërkonti ndihme kur jeni në kohë.



**UJORI**

Nuk lejoni askënd të prekë parimet tuaja dhe për këtë gjë jeni mjaft krenare. Por, të tjerët do ta keqinterpretjnë këtë virtut që keni.



**PESHQIT**

Kjo ditë do të nisë me ide të reja që doni t'i vini sa më shpejt në zbatim. Do të kuptoni që nëse gjërat nisin mbarë finalizimi do të jetë shumë i shpejtë.

**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE

"BUJQËSIA"

TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

WEST BROM - ASTON VILLA

GG

LEGANES - GETAFE

2

WERDER BREMEN - DUSSELDORF

1

# Batatina: Llapi fiton titullin dhe del në Evropë

Tahir Batatina është optimist se Llapi do të dalë në Evropë ani pse kjo skuadër tashmë është eliminuar nga gara e Kupës dhe për të arritur një synim të titull e ka triumfin në kampionat.

"Llapi që tre vjet është afër për ta siguruar daljen në Evropë, por nuk kemi arritur të bëjmë një gjë të tillë për nuanca të vogla. Tash jemi eliminuar nga Kupa dhe e kemi më të lehtë të fokusohemi vetëm në një garë për titull. Të shohim si do të ecë kampionati në pranverë. Besojmë se do ta fitojmë titullin dhe të dalim në Evropë", ka thënë Batatina

**EPOKA E RE**

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 6 DHJETOR - Skuadra e Llapit është eliminuar nga gara e Kupës dhe ka mbetur një hap pas në garën për titull të kampionit në IPKO Superligën e Kosovës në futboll. Drejtori sportiv Tahir Batatina të enjten për "Epokë e re" ka thënë se skuadra e Llapit do të dalë në Evropë. "Llapi që tre vjet është afër për ta siguruar daljen në Evropë, por nuk kemi arritur të bëjmë një gjë të tillë për nuanca të vogla. Tash jemi eliminuar nga Kupa dhe kemi më të lehtë të fokusohemi vetëm në një garë për titull. Të shohim si do të ecë kampionati në pranverë, por besojmë se do ta fitojmë titullin dhe të dalim në Evropë. E mira është që kemi ndeshje të drejtpërdrejta dhe Llapi do ta shkrijë epërsinë e Prishtinës dhe Feronikelit. Cilësia e tri skuadrave është thaujse e

njëjtë dhe nuancat e vogla do ta vendosin titullin", ka thënë Batatina. Ish-trajneri i Llapit, që tash e kryen detyrën e drejtorit sportiv dhe ekzekutiv, e ka analizuar edhe sezonin vjeshtor, duke thënë se e mira e të gjithave është fakti se skuadra e Llapit ende është në garën për titull. "Nuk e kemi filluar mirë edicionin në Superligë edhe pse kishim shumë përforsime. Ndërkohë kishim probleme me lëndimin, por në ndeshjet e fundit kemi marrë rezultate pozitive. Sezonin vjeshtor e kemi mbyllur në pozitën e tretë që nuk është pozitë aq e mirë, por rëndësi ka se jemi ende në garë për titull të kampionit dhe me një fitore dhe një humbje dallimi do të zvogëlohet. Do ta japim maksimumin që në fund ta arrijmë objektivin që të dalim në Evropë", ka shtuar ai. Tahir Batatina në fund foli edhe për trajnerin e ri në skuadrën e Llapit,

duke e përjashtuar mundësinë që të rikthehet në pozitën e trajnerit. Ai nuk e ka përjashtuar mundësinë që Bekim Shotani të jetë trajner i Llapit edhe në pranverë. "Marrëveshje me Bekimin kemi pasur deri në përfundim të sezonit vjeshtor dhe tash do të ulemi dhe të vendosim për trajnerin e ri. Unë nuk do të jem trajner i Llapit në pranverë, pasi e kam thënë edhe në fillim të kampionatit se në këtë edicion nuk do të jem trajner, pasi do ta menaxhoj skuadrën nga detyra e drejtorit sportiv. Gjithmonë planifikoj ta marr skuadrën nga ndeshja e parë dhe jo në mes të kampionatit", ka deklaruar Batatina. Skuadra e Llapit u mposhtë nga Trepça '89 dhe u eliminua nga gara e Kupës, kurse kampionatin e mbylli në pozitën e tretë me 35 pikë të grumbulluara, katër më pak se skuadra e Feronikelit dhe pesë më pak se Prishtina që është lidere në elitë.

SHKURT

## U17-shat dhe U19-shat mësojnë kundërshtarët

